



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01.nr.16-53246 të datës 13.06.2013, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01.nr.143/2015, të datës 20.11.2015 Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 30.11.2015, merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR
TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2016

1. Me këtë vendim themelohet Grupi punues për hartimin e Planit vjetor të punës për vitin 2016 të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Grupi punues ka këtë përbërje:

- 1.1.Valentina Bunjaku-Rexhepi,
 - 1.2.Nevzad Rushiti, anëtarë
 - 1.3.Myzaferre Ismajli, anëtare
 - 1.4.Riad Rashiti, anëtarë
 - 1.5.Adelina Berisha, anëtare
2. Grupi punues si në pikën 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin e ardhshëm kalendarik dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.
 3. Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.
 4. Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.016-114557
Gjilan, më 30.11.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi